



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

14 MAJ 2023

KUJTESË

PËR **GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE**



1. Merrni vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave
2. Kryeni, në mënyrë të pandërprerë numërimin e të gjitha kutive të pranuar të rregullta nga KZAZ.
3. Mos refuzoni numërimin e kutive të votimit pasi refuzimi përbën vepër penale.
4. Sekretar i GNV, merr me radhë dhe sipas rendit rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi dhe vendosni në tavolinën tuaj të numërimit etiketën adezive me numrin e qendrës së votimit që numërohet.
5. Sekretar i GNV, merr nga KZAZ, dosjen përkatëse të KQV, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ në KQV.
6. Numërues i parë, për hapjen e kutisë së votimit kryej këto veprime:
 - a) ekspozo në ekran për jo më pak se 2 sekonda faqen anësore të kutisë ku është vendosur etiketa me numrin e qendrës së votimit.
 - b) Këput vulat me kodet e sigurisë
 - c) Nxirr nga kutia procesverbalin për mbylljen e votimit
7. Verifikoni të dhënat e plotësuara në procesverbalin për mbylljen e votimit.
8. Nëse procesverbali për mbylljen e votimit është në kutinë e votimit dhe është plotësuar saktë, filloni numërimin e votave dhe vlerësimin e tyre.
9. Nxirrni nga kutia , fletët e votimit dhe procesverbalin e vulosjes
10. Shpalosni në tavolinë, fletët e votimit në pjesën e pasme të tyre nga ana e sipërme.
11. Lini mënjane, pa bërë vlerësim, fletët e votimit që i përkasin një organi tjetër.
12. Numërues i parë, numëro fletët e votimit të shpalosura në tavolinë dhe ë përfundim bëje të ditur këtë shifër për GNV dhe vëzhguesit.
13. Verifiko shifrën e deklaruar përfshirë edhe atë të votave të hedhura gabim me shifrën e procesverbalit për mbylljen e votimit. saktësinë e plotësimit të procesverbalit të mbylljes së votimit
14. Numërues i parë, kryej rinumërim të fletëve të votimit nëse kërkohet nga anëtarët e GNV.
15. Numërues i parë, vendosi fletët një e nga një në kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme jo më pak se 3 sekonda që të shihen vulat.
16. Numërues i parë, deklaro me zë të lartë fletët e votimit që i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.
17. Vendosi fletët e kontestuara në vendin për fletët e votimit të kontestuara.
18. Kryeni vlerësimin e votës duke identifikuar sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhsit.
19. Numërues i parë, vendos fletën e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda në mënyrë që shenja e cila tregon vullnetin e zgjedhësit të shikohet qartësisht në monitor dhe bëj vlerësimin e votës me zë të lartë.
20. Rivlerësoni fletët e votimit të kontestuara.
21. Informoni vëzhguesit për përfundimin e rivlerësimit.
22. Thërrisni KZAZ për të bërë vlerësimin e votave të mbetura të kontestuara pas procesit të rivlerësimit të bërë nga ju.
23. Përcaktoni në tavolinën e numërimit, vende të veçanta për fletët e votimit të vlefshme, të pavlefshme apo të kontestuara.
24. Numërues i parë, vendos në monitor, fletën e votimit në jo më pak se 3 sekonda.
25. Numërues i parë, verifiko fletën e votimit nga pjesa e pasme dhe deklaro me zë të lartë votat e pavlefshme.
26. Numërues i parë, vendos fletët e kontestuara në vendin e përcaktuar.

27. Njoftoni menjëherë KZAZ, duke ngritur dorën, kur në kutinë e votimit nuk gjendet procesverbal për mbylljen e votimit apo kur ky procesverbal nuk është plotësuar saktë.
28. Në rastet e hapjes së kutisë së materialeve të votimit dhe procesverbal për mbylljen e votimit gjendet në këtë kuti kryeni këto veprime:
 - a) Dorëzoheni procesverbalin tek KZAZ
 - b) Sekretar i GNV shëno numrat e kodeve për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit në procesverbalin e grupit të numërimit dhe fute atë në kutinë e materialeve të votimit.
 - c) Numërues i parë, mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kodet e sigurisë dhe vendose këtë kuti pranë tavolinës. Merr kutinë e votimit të QV , numërimi i së cilës ishte pezulluar.
29. Në rastet e hapjes së kutisë së materialeve të votimit dhe procesverbal për mbylljen e votimit nuk gjendet në këtë kuti, kryeni këto veprime
 - a) verifikoni të gjithë dokumentacionin e gjendur në të.
 - b) Numërues i parë, krahaso vulën e kryetarit me modelin krahasues si dhe numëro fletët e votimit të papërdorura e të dëmtuara, si dhe numrin e zgjedhësve që kanë votuar si dhe deklaro numrin e zgjedhësve që kanë votuar anëtarëve të GNV dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.
30. Numërues i parë, hidh të dhënat për numrin e zgjedhësve që kanë votuar, fletët e votimit të papërdorura dhe ato të dëmtuara në tabelën për qendrën e votimit.
31. Sekretar i GNV, shëno numrat e kodeve në procesverbalin e mbylljes së kutisë së materialeve të votimit.
32. Numërues i parë, mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kode sigurie dhe merr kutinë e qendrës së votimit përkatëse që ishte pezulluar.
33. Plotësoni tabelën e rezultateve për qendrën e votimit, në përfundim të numërimit të asaj qendre votimi.
34. Nënshkruani tabelën e rezultateve të QV së numëruar edhe në rast se keni kundërshtime, të cilat i pasqyroni në rubrikën përkatëse të tabelës.
35. Shfaqni tabelën e rezultateve në kamera për jo më pak se 4 sekonda dhe dorëzohani atë KZAZ.
36. Sekretar i GNV, Shëno kundërshtimet e vëzhguesve të tavolinës ku u krye numërimi në librin e protokollit të mbledhjeve.
37. Mbyllni kutinë me fletët e votimit, pas nxjerrjes së rezultatit dhe plotësimit të tabelës së rezultateve të QV duke futur më parë në kutinë e votimit zarfet me fletët e votimit të pavlefshme, të kontestuara, procesverbalin për hapjen e votimit, mbylljen e tij dhe atë të vulosjes dhe mbylleni atë me vula me kode sigurie të reja.
38. Numërues i parë, plotëso procesverbalin e konstatimit për votat e hedhura gabim, pasi GNV ka përfunduar së numëruari kutinë e fundit të saj, fute këtë procesverbal në zarfin përkatës dhe dorëzoja sekretarit të KZAZ.
39. Grupi i numërimit të votave i caktuar nga KZAZ për numërimin dhe vlerësimin e votave të hedhura në kutitë e gabuara merr nga sekretari i KZAZ procesverbalin e vulosjes me kodet e sigurisë së vulave me të cilat është mbyllur kutia përkatëse dhe verifikon përputhshmërinë e numrave të vulave të kodeve të sigurisë.
40. Kryeni procedurat për numërimin dhe vlerësimin e votave të hedhura në kutitë e gabuara.
41. Hidhni rezultatet e secilës kuti me vota të hedhura gabim në tabelën e veçantë për vota të hedhura gabim.



Për ndihmë nga KQZ telefono pa pagesë në

0800 0803

Skano QR Code më poshtë për Telegram dhe Whatsapp
për te marrë udhëzimet & informacionet në kohë reale nga KQZ



SHKARKO, në telefonin tënd celular aplikacionin "KQZ", për të marrë
informacion dhe për të raportuar në KQZ, sipas udhëzimeve përkatëse.



Available on the
App Store

GET IT ON
Google Play

